

Njoftim

Me datën 24.01.2019 në ora 12:00 në sallën e Kuvendit Komunal në Dragash do të organizohet Sesi i Informues për Skemën e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2019, nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Të gjithë ata që deshirojnë të fillojnë një biznes dhe të gjithë bizneset ekzistuese që deshirojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre i ftojmë që të marrin pjesë në këtë takim për tu njoftuar me grantet që ofron Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin 2019.

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrësit e rinj, si dhe bizneset ekzistuese, sipas loteve të mëposhtme:

Lot 1 – Ndërmarrësit e rinj (2,000 – 5,000 EUR)

Lot 2 – Bizneset e reja deri 2 vjet (5,000 – 15,000 EUR)

Lot 3 – Bizneset më të vjetra se 2 vjet (15,000 – 25,000 EUR)

Bashkëfinancimi i aplikantëve duhet të jetë prej 10 – 40%. Fondi total për këtë skemë të granteve është 2,4 milion euro. Afati i fundit për aplikim 22.02.2019.

Rreth formës së aplikimit, dokumentacionet e nevojshme, shumat e granteve do të njoftoheni nga Agjensioni për Zhvillim Jug në bashkëpunim me Komunën e Dragashit

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

18.01.2019